



Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

RELACION
PËR
PROJEKTVEKNDIMIN
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS SË MONITORIMIT TË
ZGJEDHJEVE DHE MBIKËQYRJES SË VEPRIMTARISË SË ADMINISTRATËS
ZGJEDHORE (SMZM)

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “b” dhe “n” dhe pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Ky projektvendim ka objekt krijimin e një strukture të posaçme pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), që do të garantojë monitorimin dhe mbikëqyrjen efektive të veprimtarisë së administratës zgjedhore gjatë periudhës zgjedhore.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Qëllimi i projektvendimit të propozuar është krijimi i një strukture të posaçme pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), që do të garantojë monitorimin dhe mbikëqyrjen efektive të veprimtarisë së administratës zgjedhore gjatë periudhës zgjedhore. Kjo strukturë ad hoc, me emërtimin si Struktura e Monitorimit të Zgjedhjeve dhe e Mbikëqyrjes (SMZM), synon të sigurojë:

1. Mbikëqyrjen në kohë reale të veprimtarive të KZAZ-ve dhe KQV-ve.
2. Evidentimin dhe adresimin e problematikave të konstatuara gjatë procesit zgjedhor.
3. Zbatimin strikt të rregullave dhe procedurave zgjedhore.
4. Koordinimin efektiv të informacionit mes administratës zgjedhore dhe strukturave qendrore të KQZ-së.

Ky projektvendim vjen si një domosdoshmëri për rritjen e efikasitetit të monitorimit zgjedhor duke qene se ekziston një nevojë e theksuar për një strukturë të posaçme që monitoron dhe raporton në kohë reale.

Ngritja e kësaj strukture synon të sigurojë të orientojë që të gjitha vendimet dhe veprimet e administratës zgjedhore të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Strukturimi dhe përcaktimi i roleve të qarta brenda SMZM do të ndihmojë në shmangien e



situatave që mund të cenojnë procesin.

Projektvendimi propozon që SMZM të ngrihet pranë KQZ dhe do të përbëhet nga mbikqyrës të caktuar nga Drejtoria e Administratës Zgjedhore (DAZ). Organizimi do të ndjekë tri faza kryesore:

- Nga momenti i konstituimit të KZAZ-ve deri një ditë para zgjedhjeve.
- Gjatë ditës së zgjedhjeve.
- Nga mbyllja e procesit të votimit deri në shpalljen e rezultateve dhe dorëzimin e materialeve zgjedhore.

Projektvendimi parashikon procedurën e marrjes dhe administrimit të informacionit, nëpërmjet:

- Përdorimi i aplikacionit KQZ për monitorimin e vendimeve të KZAZ-ve dhe afateve të tyre si dhe te sistemeve CCTV.
- Evidentimit të problematikave dhe përcjelljen e udhëzimeve teknike sipas rastit nëpërmjet platformave të komunikimit
- Koordinimin e informacionit me inspektorët e zonës dhe strukturat e tjera të KQZ-së.

Ky projekt vendim synon që të rrisë efikasitetin e administratës zgjedhore nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, për identifikimin dhe trajtimin në kohë të problematikave më qëllim minimizim e riskut dhe parregullsive dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies tek administrate e niveleve më të ulëta.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e dokumentacionit të punës të Komisioneve të Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për Kuvend”.

Erion META - Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Pavlina DOÇAJ - Drejtoria e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA - Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data:

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

VENDIM

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS SË MONITORIMIT TË
ZGJEDHJEVE DHE MBIKQYRJES SË VEPRIMTARISË SË ADMINISTRATËS
ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1 shkronja “b” , “dh” e “n”, dhe pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S:

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim ngritjen e Strukturës së Monitorimit të Zgjedhjeve dhe të Mbikqyrjes së veprimtarisë së administratës zgjedhore (SMZM), si dhe përcaktimin e rregullave përkatëse të organizimit dhe të funksionimit të kësaj qendre pranë KQZ-së.

Neni 2

Struktura e Monitorimit të Zgjedhjeve dhe e Mbikqyrjes (SMZM), organizimi

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ngrihet Struktura e Monitorimit të Zgjedhjeve dhe e Mbikqyrjes (SMZM).
2. SMZM ngrihet jo më vonë se 3 muaj përpara datës së zgjedhjeve.
3. SMZM përbëhet nga mbikqyrësit, të cilët caktohen nga Drejtoria e Administratës Zgjedhore (DAZ).

Data: Nr:
Ora:



“Për organizimin dhe funksionimin e strukturës së monitorimit të zgjedhjeve dhe mbikqyrjes së veprimtarisë së administratës zgjedhore”

4. SMZM mbikqyr veprimtarinë e KZAZ dhe të KQV dhe koordinon me to për periudhën nga momenti i ngritjes deri në shpalljen e rezultatit nga KZAZ dhe dorëzimin e dokumentacionit zgjedhor në KQZ. Mbikqyrësi është përgjegjës për monitorimin e një apo disa KZAZ-ve, apo KQV-ve.
5. Mbikqyrja dhe monitorimi përfshin tre periudha:
 - a. Nga momenti i konstituimit të Komisioneve të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) deri një ditë para datës së zgjedhjeve;
 - b. Ditën e zgjedhjeve;
 - c. Nga mbyllja e votimit deri në shpalljen e rezultatit nga KZAZ dhe dorëzimin e dokumentacionit zgjedhor në KQZ.

Neni 3

Procedura e marrjes dhe administrimit të informacionit

1. Çdo mbikqyrës merr informacion në lidhje me procesin si dhe veprimtarinë e KZAZ, apo KQV nëpërmjet aplikacionit KQZ, platformave të komunikimit Ëhatsapp, Telegram, medias, rrjeteve sociale, linjës telefonike, sistemeve të monitorimit me kamera, informacioneve nga palë të treta dërguar në KQZ, etj.
2. Çdo mbikqyrës monitoron aplikacionin KQZ, duke kontrolluar vendimet e marra nga KZAZ-të, ose sipas rastit nga KQV. Bazuar në raportimet e aplikacionit, mbikqyrësi identifikon KZAZ-të që nuk kanë respektuar afatet, kanë raportuar problematika duke ja referuar përgjegjësit të mbikqyrësve.
3. Mbikqyrësi evidenton problematikën dhe u dërgon udhëzime teknike KZAZ-ve, ose KQV bazuar në dokumentet dhe udhëzimet teknike të përgatitura nga strukturat e KQZ-së.
4. Informacionet e mbledhura koordinohen me inspektorët e Sektorit të Koordinimit dhe strukturat e tjera përkatëse të KQZ-së, duke shënuar statusin dhe kategorizuar problematikën.
5. Mbikqyrësit identifikojnë problematikën bazuar në raportimet nga burimet e informacionit që monitorojnë.
6. Mbikqyrësi kontakton me KQV dhe KZAZ për të verifikuar situatën dhe ja përcjell informacionin përgjegjësit të mbikëqyrësve.
7. Përgjegjësi delegon rastin inspektorëve të zonës, duke informuar Drejtorin e DAZ dhe Komisionerin/Nënkomisionerin.

Data: Nr:
Ora:



“Për organizimin dhe funksionimin e struktures se monitorimit te zgjedhjeve dhe mbikqyrjes se veprimtarise se administrates zgjedhore”

8. Mbikqyrësi evidenton statusin e zgjidhjes dhe përcjell udhëzime të standardizuara sipas instruksioneve të eprorëve.
9. Pas mbylljes së procesit të votimit, mbikqyrësit kontaktojnë me KZAZ-të dhe ndjekin procesin e dorëzimit të materialeve zgjedhore.
10. Koordinojnë oraret e fillimit të procesit të numërimit dhe ndjekin monitorimin e procesit deri në shpalljen e rezultateve.
11. Mbikqyrësit ndjekin procesin e fillimit të numërimit të votave, duke ndjekur në kohe reale nga sistemet CCTV procesin e numërimit dhe duke raportuar çdo problematikë apo vonesë.
12. Mbikqyrësit trajtojnë kërkesat dhe problematikat e shfaqura në KZAZ-të ku janë ngarkuar dhe informojnë strukturat përkatëse të KQZ-së.
13. Inspektoret e Sektorit të Koordinimit raportojnë tek Drejtori i DAZ dhe Komisioneri për masat e marra, dhe koordinojnë udhëzimet e KQZ-së me struktura të pushtetit lokal dhe partitë politike.

Neni 4

Përgatitja e raporteve

1. Çështjet e raportuara nga administrata zgjedhore duhet të adresohen sipas niveleve në vijim:
 - a. Niveli i parë (kritik), do të konsiderohen raste që pengojnë procesin zgjedhor. Në këtë nivel raportimi duhet të adresohet brenda 30 minutave nga momenti i raportimit.
 - b. Niveli i dytë (jo-kritik), do të konsiderohen çështjet që ndikojnë por nuk pengojnë procesin zgjedhor dhe duhet të zgjidhen brenda 2 orëve.
 - c. Niveli i tretë (të zakonshme), do të konsiderohen çështjet administrative ose teknike që nuk ndikojnë drejtpërdrejt procesin dhe mund të adresohen brenda 5-24 orëve.
2. Mbikqyrësit do të raportojnë në kohë reale në sistemet e menaxhimit të KQZ-së për çdo çështje të raportuar, të trajtuar ose që kërkon ndërhyrje.
3. Raportet do të pasqyrojnë numrin e rasteve të adresuara, llojet e problematikave, burimin e informacionit dhe veprimet e ndërmarra.
4. Për çdo rast problematik, mbikqyrësit përpilojnë raporte të detajuara që ja kalojnë përgjegjësit të zonës, i cili delegon trajtimin tek inspektorët përkatës dhe informon Drejtorin dhe Komisionerin/Nënkomisionerin.

Data: Nr:
Ora:



“Për organizimin dhe funksionimin e struktures së monitorimit të zgjedhjeve dhe mbikqyrjes së veprimtarisë së administratës zgjedhore”

5. Pas shpalljes së rezultateve zyrtare, mbikqyrësit përmbledhin të gjitha raportet dhe i dorëzojnë në formë elektronike tek Sektori i Koordinimit për analizë të mëtejshme.

Neni 5

Teknologjia mbështetëse

1. Struktura e Monitorimit e KQZ-së do të pajiset me linjat telefonike të ndihmës dhe do të jetë me numeracion të thjeshtë, lehtësisht të aksesueshem dhe pa pagese.
2. Në funksion të dokumentimit të ngjarjeve struktura do të pajiset me infrastrukturën e nevojshme për të pranuar dhe menaxhuar raportimet nëpërmjet platformave të regjistrimit të thirrjeve për raste emergjente.
3. Platforma e regjistrimit të thirrjeve telefonike dhe do të mundësoj identifikimin e thirrjeve, kohën, kategorizimin e raportimeve, regjistrimin e veprimeve të marra dhe përgjigjen.
4. Regjistrimet do të ruhen deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, ndërsa të dhënat e tjera statistikore ruhen në formë elektronike.

Neni 6

Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve për zbatimin dhe monitorimin e këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: Nr:
Ora:



“Për organizimin dhe funksionimin e struktures së monitorimit të zgjedhjeve dhe mbikqyrjes së veprimtarisë së administratës zgjedhore”